



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

MISSION ARCHIVE	
OSCE Mission to Skopje	
Date: 08.03.2023	
HD.2	
Reg. No.	044/2023 -translat



MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET

ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË

MISIONI NË SHKUP

DHE

KOMISIONIT SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

PËR IMPLEMENTIMIN E AKTIVITETEVE TË PËRBASHKËTA NË PERIUdhËN 2023-24



Ky Memorandum bashkëpunimi (më tej në tekst i shkruar si “Memorandumi”) është i nënshkruar ndërmjet **Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë** (më tej në tekst e shkruar si “OSBE”), nëpërmjet Misionit në Shkup (më tej në tekst e shkruar si “misioni”), me adresë në Pallati Hiperium, Bul. 8 shtatori, nr. 16, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,

dhe

Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (më tej në tekst e shkruar si “KSHPK”) me adresë në Bul. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Më tej në tekst, Misioni dhe KSHPK emërohen individualisht si “Pala”, dhe së bashku si – “Palët”,

DUKE MARRË PARASYSH se Misioni ka mandat që të ndihmojë përpjekjet e shtetit nikoqir në reformimin e administratës publike dhe demokratizimin e shoqërisë nëpërmjet promovimit të parimeve të udhëheqjes demokratike dhe politikave kundër korrupsionit të bazuara në dëshmi, e në përputhshmëri me zotimet e OSBE-së, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira;

dhe

DUKE MARRË PARASYSH se KSHPK është i përkushtuar në zbatimin e ligjeve, përf forcimin normativ dhe institucional, në krijimin e politikave dhe masave antikorruptive, promovimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe zhvillimin e kulturës legale drejt themelimit të një sistemi efikas për parandalim dhe shtypjen e korrupsionit e konfliktit të interesave.

Palët u dakorduan si në vijim:

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi i Memorandumit

Ky Memorandum krijon kornizë bashkëpunimi ndërmjet Palëve me qëllim zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta të cilat synojnë avancimin e praktikave për parandalimin e korrupsionit dhe përforcimin e sistemit të integritetit. Aktivitetet e përbashkëta fillimisht do të përputhen me parimet e përcaktuara nga Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave 2021-25, e sjellur nga KSHPK dhe e miratuar nga Kuvendi, dokumentet tjera strategjike, si dhe aktivitete tjera të cilat dakordohen mes palëve. Aktivitetet e përbashkëta, përfshirë këtu afatet dhe detajet tjera në lidhje me realizimin e tyre do të përcaktohen kur do të përpilohet Plani i përbashkët vjetor i aktiviteteve, i cili do të miratohet nga palët përmes kontakt personave të evidentuar më poshtë.

Neni 2

Përgjegjësitë e Misionit

Në pajtim me dispozitat e këtij Memorandumi, Misioni:

1. Do t'i sigurojë përkrahje profesionale KSHPK-së në përpjekjet për zbatimin e aktiviteteve nga sfera e parandalimit të korrupsionit dhe përforcimit të integritetit personal dhe institucional në pajtim me zotimet e OSBE-së dhe standardet kombëtare e ndërkombëtare;
2. Do të koordinojë dhe bashkëpunojë me KSHPK-në, si dhe me palët e tjera të interesit për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta;
3. Do ta financojë zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe do të mbajë vetë përgjegjësi për përdorimin e disponueshmërinë e mjeteve financiare, në pajtim me rregullat dhe rregulloret e veta;
4. Do të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në Planin vjetor të aktiviteteve.

Neni 3

Përgjegjësitë e KSHKP-së

Në pajtim me nenet e këtij Memorandumi, KSHKP:

1. Do të bashkëpunojë me Misionin dhe do ta promovojë zbatimin e legjislacionit kombëtar kundër korrupsionit, zotimet ndërkombëtare dhe standardet e OSBE-së në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit;
2. Do të komunikojë me institucionet dhe organet përkatëse kombëtare, si dhe palët tjera të interesit, me qëllim zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta;

3. Do t'i ndërmarrë të gjitha masat për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të përbashkëta, duke përfshirë edhe informimin në kohë dhe të saktë të Misionit për vështirësitë eventuale të cilat mund të paraqiten gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta;
4. Do të veprojë në pajtim me legjislacionin relevant dhe në kohë do t'i sigurojë lejet/pëlqimet e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të përbashkëta;
5. Do të kryejë detyra tjera të përcaktuara në Planin vjetor të aktiviteteve.

Neni 4

Përgjegjësitë dhe dëmshpërblimi

1. OSBE-ja nuk ndërmerr përgjegjësi apo detyrim për mbulim të pretendimeve për borxhe, dëme, kërkesa apo humbje si rezultat i veprimeve apo mosveprimeve të qëllimshme që i atribuohen drejtpërdrejt KSHPK-së ose palëve të treta gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta.
2. Palët sigurohen që zyrtarët e tyre, agjentët dhe personat që kryejnë shërbime për to dhe çdo person tjetër nën mbikëqyrjen e Palëve me qëllim të zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta, do të shmangin çdo veprim që mund të reflektojë negativisht mbi imazhin dhe statusin e Palëve.

Neni 5

Publiciteti

Aty ku është e përshtatshme, KSHKP do të falënderojë OSBE-në në publikime, në mjetet e mësimin online, fjalime dhe kumtesa publike apo media të tjera të ngjashme.

Neni 6

Pronësia intelektuale

1. Të gjitha të drejtat dhe interesat, përfshirë pa kufizime edhe të drejtat autoriale për çdo material të prodhuar, zbuluar apo zhvilluar në suaza të zbatimit të këtij Memorandumi ngelin ekskluzivisht në pronësi të OSBE-së. KSHPK mund të përdorë materialet e prodhuara, zbuluara apo zhvilluara gjatë aktiviteteve të përbashkëta në mënyrë të përshtatshme me dhe siç është parashikuar nga aktivitetet e përbashkëta.
2. KSHPK mund të përdorë emrin dhe logon e OSBE-së ose të Misionit vetëm në lidhje të drejtpërdrejtë me aktivitetet e përbashkëta, dhe me pëlqim paraprak me shkrim të Misionit.
3. OSBE-ja mund t'i redaktojë materialet e shtypura, elektronike ose resurset e tjera të përpiluara gjatë zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta që ti përputhë me rregullat interne stilistike të OSBE-së, identitetin vizual, standardet gjuhësore, politikat dhe kërkesat e OSBE-së.

Neni 7

Mos-përfitimi i zyrtarëve

Palët nuk do t'i mundësojnë asnjë zyrtari të Palës tjetër ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë ose indirekt ose trajtim preferencial në bazë të këtij Memorandumi. Çdo shkelje e kësaj dispozite përbën shkelje thelbësore të këtij Memorandumi.

Neni 8

Komunikimi

Të gjitha komunikimet që kanë të bëjnë me implementimin e aktiviteteve të përbashkëta do të adresohen përmes kontakt personave në vijim:

Për Misionin:

Alesio Xukarini, Shef i Departamentit për
Dimenzionin Njerëzor
Adresa: Ndërtesa Hyperium,
Bul. 8 Shtatori, nr. 16, 1000, Shkup
Telefoni: [+389 2] 3234000
Telefaksi: [+389 2] 3234234
E-mail: alessio.zuccarini@osce.org

Për KSHPK-në:

Projekt menaxher: Maja Koneska, Sektori
për Planifikim Strategjik dhe Integritet
Adresa: Bul. Presveta Bogorodica nr.3,
1000 Shkup.
Celulari: +389 70 342774
Telefaksi: +389 2 3215380
E-mail: mkonevska@dksk.org.mk
contact@dksk.org.mk

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të bëjnë përpjekje që të gjitha mosmarrëveshjet që dalin nga ky Memorandum, ose janë në lidhje me të njëjtin ose rezultojnë nga interpretimi i të njëjtit t'i zgjidhin në mënyrë paqësore. Të gjitha dallimet, polemikat apo pretendimet që mund të dalin gjatë aplikimit të dispozitave të Memorandumit do të zgjidhen përmes negociatave miqësore mes Palëve. Në rast se Palët dështojnë në zgjidhjen miqësore të kontesteve brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga fillimi i negociatave, kontestet do të zgjidhen nëpërmjet arbitrazhit. Arbitrazhi do të bëhet në përputhje me rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL. Do të caktohet një (1) arbitër i cili do të gëzojë fuqi të plotë për të ndërmarrë vendime finale dhe obliguese. Gjyqi Permanent i Arbitrazhit në Hagë do të jetë autoriteti i emërimit. Vendi i arbitrazhit do të jenë Vjena, ndërsa e gjuha që do të përdoret gjatë arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.

Neni 10

Privilegjet dhe Imuniteti

Asgjë që përmban ky Memorandum ose është në lidhje me të njëjtin nuk mund të konsiderohet si heqje dorë e privilegjeve apo imunitetit që gëzon OSBE-ja.

Neni 11

Ndryshimet

1. Çdo ndryshim i këtij Memorandumi duhet të bëhet me miratimin e Palëve dhe në formë të shkruar.
2. Ky Memorandum zëvendëson të gjitha deklaratat paraprake të shkruara apo gojore, marrëveshjet dhe përfaqësimet e palëve lidhur me aktivitetet e përbashkëta.

Neni 12

Përfundimi

1. Në rast se Pala beson se ky Memorandum nuk mund të zbatohet në mënyrë efikase apo të përshtatshme, do ta konsultojë menjëherë Palën tjetër. Në rast se nuk arrihet një zgjidhje adekuate, Memorandumi mund të shfuqizohet më herët nga cilado Palë duke i dhënë pal[es tjetër paralajmërim me shkrim prej jo më pak se tridhjetë (30) ditëve kalendarike. Në atë rast, data e shfuqizimit do të përshtatet për të lejuar përfundimin e rregullt të operacioneve lidhur me implementimin e aktiviteteve të përbashkëta.
2. Misioni mund ta shfuqizojë këtë Memorandum menjëherë dhe në tërësi në rast të kufizimeve buxhetore ose ndryshim të mandatit të Misionit.

Neni 13

Tërësia e Memorandumit

Plani vjetor i aktiviteteve i paraparë në Nenin 1 si dhe shtojcat e tjera janë pjesë përbërëse e këtij Memorandumi. Nëse ka mospajtim ose konflikt mes neneve të Memorandumit dhe anekseve, do të mbisundojnë dispozitat e këtij Memorandumi.

Neni 14

Validiteti i vazhduar

Dispozitat e Nenit 4 (Përgjegjësitë dhe dëmshpërblimit), 6 (Pronësia intelektuale), 9 (Zgjidhja e mosmarrëveshjeve) dhe 10 (Privilegjet dhe imunitetet) do të zbatohen edhe pas mbarimit, gjegjësisht skadimit të afatit të këtij Memorandumi.

Neni 15

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

Ky Memorandum hyn në fuqi prej momentit të nënshkrimit nga Palët dhe vlen deri më 31 dhjetor të vitit 2024, përveç nëse cilado nga Palët vendosë të shfuqizojë atë më herët duke i dhënë palës tjetër paralajmërim me shkrim në përputhshmëri me Nenin 12 të këtij Memorandumi. Nëse do të jetë e nevojshme, vlefshmëria e këtij Memorandumi si dhe afati i mbarimit të aktiviteteve të përbashkëta mund të vazhdohen ose adaptohen, me marrëveshje të përbashkët nga Palët.

Ky Memorandum është i përpiluar në dy (2) ekzemplarë në gjuhën angleze dhe dy (2) ekzemplarë në gjuhën maqedonase, nga një kopje prej çdo gjuhe për çdo Palë. Përkthimi i këtij

Memorandumi në gjuhën maqedonase dhe shqipe do të shërbejë vetëm për qëllime informative. Në rast të mos pajtimit lidhur me interpretimin e dispozitave, do të mbizotërojë versioni në anglisht.



Për OSBE-në
Ambasadori Kilian Wahl
Shef i OSBE-së, Misioni në Shkup



Për KSHPK-në
Biljana Ivanovska
Kryetare e KSHPK-së

Data: _____

Data: 